



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 12611 prot.

Shkodër, më 28.5. 2026

**VENDIM  
Nr. 44, datë 28.05.2026**

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT MAKSIMAL TË ÇADRAVE DHE SHEZLONGËVE  
PËR ZONËN BREGDETARE VELIPOJË-RRJOLL, PËR ZBATIM NGA SUBJEKTET  
PRIVATE**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 28.05.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; në Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, të ndryshuar; në nenin 6/1 të VKM-së nr. 649, datë 16.10.2024 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, i ndryshuar; si dhe në dokumentacionin e përgatitur nga administrata e bashkisë,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e çmimit maksimal për dhënien me qira të 1 (një) çadre dhe 2 (dy) shezlongëve, në vlerën 900 lekë me TVSH, për plazhet e Velipojës dhe Rrjollit.
2. Miratimin e çmimit maksimal për dhënien me qira të 1 (një) gazeboje, në vlerën 1,500 lekë me TVSH.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 26 vota

Vota Pro 26  
Vota Kundër 1  
Vota Abstenim 3  
Zbardhur me datë 28.05.2026

**SEKRETARE**

Sabina Danaj

**KRYETAR**

Ortion LALLI



Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër, web: [www.bashkiashkoder.gov.al](http://www.bashkiashkoder.gov.al), e-mail: [info@bashkiashkoder.gov.al](mailto:info@bashkiashkoder.gov.al)